

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Presidenti i SHBA - Trump njofton marrëveshjen me Danimarkën për Groenlandën: SHBA do të rrisë pratinë ushtarake në ishull
ADRESA	https://www.syri.net/bote/917740/trump-njofton-marreveshjen-me-danimarken-per-groenlande-n-shba-do-te-rrise-pranine-ushtarake-ne-ishull/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 06:23:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 05:55:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fad5176b271f5aedb80cfb832a34174f6a4b165b511e2544448bbe9edfea90c4
TEKSTI	feb9bc66a0697035c8627c3ee55c6e7da39cb42dfb9d35ddf6837820457d1607
PAMJA	6a62ab8db30ffbea373838941c93c23a86c725ae89f4b6cf0f455d0594109035

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f0bd28db11a4b33b33dae2196201c3dd7668692eb6918aa4e07839c159c17c32
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	e49771c1bd8e7ea1d6f74cef9fb8bb705b51ae37158277bf74b8b36f09df048a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f0bd28db11a4b33b33dae2196201c3dd7668692eb6918aa4e07839c159c17c32>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**PROF. MYQEREM TAJ**

Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!

**SONILA MEÇO**

'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi

**më të lexuarat**



Pakistanian dënon përpjekjen 'e neveritshme' për sulm me dron pranë Mekës



Forcat izraelite tërhiqen nga qyteti perëndimor i Sirisë pas një ofensive disa orëshe



Ushtria izraelite nis sulme të reja në Libanin jugor pavarësisht marrëveshjes kornizë



Filipine/ 6 nxënës të vranë dhe 17 të tjerë të plagosur nga të shtënat në një shkollë të mesme



Sanksionet e SHBA ndaj Rusisë/ Kina kundër: Marrëdhëniet dypalëshe s' duhet të prishen



Rusia dhe Ukraina shpëmbajnë sulme gjatë natës, dëme në të dyja palët

**Trump njofton marrëveshjen me Danimarkën për Groenlandën: SHBA do të rrisë praninë ushtarake në ishull**

07:55, 19/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, njoftoi se Shtetet e Bashkuara kanë arritur një marrëveshje me Danimarkën dhe Groenlandën për sigurinë në ishullin strategjik të Arktikut.

Sipas Trump, marrëveshja parashikon forcimin e pranisë ushtarake amerikane në Groenlandë dhe përjashton mundësinë që kundërshtarët e SHBA-së të krijojnë atje prani ushtarake apo ekonomike.

Arritjen e marrëveshjes e konfirmuan edhe Kopenhaga dhe Groenlanda, duke bërë të ditur se nënshkrimi pritet të bëhet javën e ardhshme, në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

Në një postim në platformën Truth Social, presidenti amerikan deklaroi se SHBA-ja ka arritur një marrëveshje me Mbretërinë e Danimarkës dhe Groenlandën, e cila, sipas tij, u garanton Shteteve të Bashkuara kontroll të përhershëm mbi sigurinë dhe të gjitha nevojat e tjera në Groenlandë.

Trump theksoi se marrëveshja adreson të gjitha shqetësimet e shumta të Shteteve të Bashkuara, ndërsa shtoi se ajo nuk do të ketë asnjë kosto për SHBA-në.

"Me urdhrin tim, ne bashkëpunuam me përfaqësues të Danimarkës dhe Groenlandës për të garantuar që Shtetet e Bashkuara të kenë përgjithmonë kapacitetin e plotë për të bërë gjithçka të nevojshme në Groenlandë, për të garantuar dhe mbrojtur sigurinë e Groenlandës dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës", shkroi ai.

Presidenti amerikan e cilësoi marrëveshjen si një marrëveshje pa fund, duke e përshkruar si një "marrëveshje me kohëzgjatje të pakufizuar" dhe duke e konsideruar zhvillimin të rëndësishëm, historik dhe të veçantë për SHBA-në.

Trump njoftoi se SHBA-ja do të nisë menjëherë procesin për vendosjen e një pranie të madhe ushtarake në ishull.

"Do të nisim menjëherë procesin e vendosjes së një pranie të madhe ushtarake në pikën e përshtatshme të Groenlandës, pasi ka shumë pika të tilla", deklaroi ai.

Në të njëjtën kohë, ai tha se SHBA-ja do të bashkëpunojë me popullin e Groenlandës për zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturës.

Sipas presidentit amerikan, marrëveshja parashikon që asnjë kundërshtar i SHBA-së të mos mund të krijojë një bazë ushtarake, të mbajë prani ushtarake apo të kryejë investime të ndjeshme në Groenlandë pa miratimin paraprak të Uashingtonit.

"Nga ky moment e tutje, asnjë kundërshtar i SHBA-së nuk mund të ketë kurrë një bazë në Groenlandë, të ketë prani ushtarake në Groenlandë apo të bëjë investime të ndjeshme në Groenlandë pa miratimin tonë të shprehur me shkrim", tha Trump.

Ai pretendoi gjithashtu se për më shumë se 100 vjet presidentët amerikanë e kanë njohur rëndësinë strategjike të Groenlandës, por askush nuk kishte arritur të ndërmerre një hap të ngjashëm.

"Jam krenar që jam presidenti që e trajtoi përfundimisht dhe në mënyrë vendimtare këtë situatë shumë të rëndësishme", u shpreh ai.

Danimarka dhe Groenlanda konfirmuan arritjen e marrëveshjes me Shtetet e Bashkuara lidhur me sigurinë në Arktik dhe në Atlantikun e Veriut.

Kryeministria daneze, Mette Frederiksen, tha se Kopenhaga dhe Groenlanda presin ta nënshkruajnë marrëveshjen me SHBA-në javën e ardhshme, në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

"E mirëpres perspektivën e një marrëveshjeje të mirë për Groenlandën, Mbretërinë e Danimarkës dhe SHBA-në", tha ajo në një deklaratë.

Kryeministria daneze theksoi se marrëveshja duhet të forcojë sigurinë e përbashkët në Arktik dhe Atlantikun e Veriut, duke nënvizuar se ajo do të jetë pozitive për NATO-n dhe Evropën.

Në të njëjtën kohë, Frederiksen theksoi se marrëveshja duhet të njohë sovranitetin dhe integritetin territorial të Mbretërisë së Danimarkës, si edhe të drejtën e popullit të Groenlandës për vetëvendosje.

Donald Trump ka deklaruar në mënyrë të përsëritur se Groenlanda ka një rëndësi kritike strategjike për sigurinë e Shteteve të Bashkuara.

Madje, ai kishte propozuar blerjen e ishullit nga Danimarka, një propozim që u refuzua nga Kopenhaga dhe Groenlanda, të cilat deklaruan se Groenlanda nuk është në shitje.

Marrëveshja e re, siç e paraqet presidenti amerikan, e zhvendos fokusin e diskutimit nga pronësia e ishullit drejt pranisë strategjike dhe ushtarake të SHBA-së në rajon.

Groenlanda, një territor autonom i Mbretërisë së Danimarkës, përbën një nga pikat më të rëndësishme gjeopolitike të Arktikut për shkak të pozicionit të saj, afërsisë me Amerikën e Veriut dhe rëndësisë në rritje të rajonit për sigurinë globale.

Rajoni ka marrë një rëndësi të shtuar edhe për shkak të rrugëve të reja detare që po krijohen në Arktik, si dhe konkurrencës së fuqive të mëdha për ndikim në këtë zonë.

Postimi i plotë i Trump

LAJMI I FUNDIT: Jam i nderuar të njoftoj se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë arritur një marrëveshje me Mbretërinë e Danimarkës dhe Groenlandën, e cila u siguron SHBA-së kontroll të përhershëm mbi sigurinë dhe të gjitha nevojat e tjera në Groenlandë, duke adresuar plotësisht të gjitha shqetësimet e shumta të Shteteve të Bashkuara.

Nuk do të ketë asnjë kosto për Shtetet e Bashkuara!

Me urdhrin tim, ne bashkëpunuam me përfaqësues të Danimarkës dhe Groenlandës për të garantuar që Shtetet e Bashkuara të kenë përgjithmonë kapacitetin e plotë për të bërë gjithçka të nevojshme në Groenlandë, për të garantuar dhe mbrojtur sigurinë e Groenlandës dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Për më tepër, nga ky moment e tutje, asnjë kundërshtar i SHBA-së nuk do të mund të ketë kurrë një bazë në Groenlandë, të mbajë prani ushtarake në Groenlandë apo të kryejë investime të ndjeshme në Groenlandë pa miratimin tonë të shprehur me shkrim.

Për më shumë se 100 vjet, presidentët e Shteteve të Bashkuara e kanë njohur

BE i hap derën Kanadasë për t'u bërë 'anëtarja e parë e asociuar' e bllokut

Trump kërcënon BE me ndërprerje të tregtisë nëse Kanadaja bëhet anëtare e asociuar

Rusia lëshon raketën Soyuz-2.1b që transporton anije kozmike

rëndësinë strategjike të Groenlandës, por asnjëri prej tyre nuk kishte arritur të bënte diçka për këtë.

Jam krenar që jam presidenti që e trajtoi përfundimisht dhe në mënyrë vendimtare këtë situatë jashtëzakonisht të rëndësishme.

Kjo është një marrëveshje me "kohëzgjatje të pakufizuar" – nuk ka fund!

Jemi jashtëzakonisht krenarë për atë që sapo ka ndodhur dhe gjithçka që u ra dakord sot do të respektohet nga populli amerikan.

Do të nisim menjëherë procesin e vendosjes së një pranie të madhe ushtarake në pikën e përshtatshme të Groenlandës, pasi ka shumë pika të tilla. Do të bashkëpunojmë me popullin e Groenlandës për zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturës.

Kjo zgjidhje është e shkëlqyer për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Danimarkën, Groenlandën dhe të gjithë aleatët tanë.

Mezi presim të bashkëpunojmë me popullin e mrekullueshëm të Danimarkës dhe Groenlandës për një të ardhme të ndritur për këtë pjesë të madhe dhe jashtëzakonisht strategjike të tokës.

Do ta mbrojmë me çdo mënyrë!

Ky është një ëndërr që bëhet realitet për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, diçka jashtëzakonisht e rëndësishme, historike dhe e veçantë.

Faleminderit për vëmendjen tuaj ndaj kësaj çështjeje!

Presidenti Donald J. Trump



Donald J. Trump
@realDonaldTrump

BREAKING NEWS: I am pleased to announce that the United States of America has entered into an Agreement with The Kingdom of Denmark, and Greenland, that gives the United States permanent control over security, and all other needs, in Greenland, completely addressing ALL of our many U.S. concerns. There will be NO COST to the United States! At my direction, we worked with representatives of Denmark and Greenland to guarantee that the United States will FOREVER have the complete ability to do what is necessary in Greenland in order to secure and defend the security of Greenland, and the United States of America. Additionally, from now on, no U.S. adversary can EVER have a base in Greenland, have a military presence in Greenland, or make sensitive investments in Greenland, without our express written approval. For over 100 years, Presidents have known the strategic importance of Greenland, but NONE of them were able to do anything about it. I am proud to be the President that permanently and conclusively addressed this very important situation. This is an "Infinite Life" Agreement, there is no end! We are very honored and proud of what has just taken place, and everything agreed to today will be cherished by the American People. We will immediately begin the process of developing a large Military presence in the appropriate part of Greenland, of which there are many. We will work with the people of Greenland in its development and construction. This solution is a great one for the United States of America, Denmark, Greenland, and all of our Allies. We look forward to working with the wonderful people of Denmark and Greenland toward a magnificent future with respect to this large, and highly strategic, parcel of land. We will be very protective of it! This is a dream come true for the United States of America, one that is very important, historic, and special. Thank you for your attention to this matter! President DONALD J. TRUMP

© SYRI.net

Lexo edhe:



Gjermania ul taksën e karburanteve dhe përgatit tavan çmimesh, paketa e ndihmës për qytetarë arrin 2.5 miliardë euro



Trump: Lufta me Iranin do të përfundojë së shpejti



Kapiteni egjiptian humb jetën pasi anija goditet pranë Rusisë, riatdhesohen 8 marinarë

TË NGJASHME



13-vjeçari sulmon me thikë mësuesen në një shkollë në Romë, sepse donte ta transmetonte live



Sulm terrorist pranë një xhamie në Pakistan, 21 të vrarë dhe mbi 70 të plagosur



Danimarka përshejton ndihmën prej 241 milionë eurosh për Ukrainën pas provokimit nga një fregatë ruse



Studimi: Bie vaksinimi i fëmijëve në Evropë, shkencëtarët paralajmërojnë për rrezikun ndaj imunitetit



Ukraina merr 3.78 miliardë dollarë nga BE, fondet përfshijnë blerjen e raketave dhe dronëve



Tortura, përdhunime e goditje elektrike! OKB: Mbi 1 mijë raste të dhunës seksuale që nga nisja e luftës në Ukrainë



Netanyahu kërcënon me heqje shtetësie për kritikët e ushtrisë izraelite

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.